VENDIM
Nr.504, datë 6.7.2011

PËR KOMPENSIMIN E VLERËS SË TAKSËS SË BIZNESIT TË VOGËL, TË PËRDORUR PËR RIMBURSIMIN E PAJISJEVE FISKALE E TË TAKSIMETRAVE, PËR 5 BASHKI DHE 10 KOMUNA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 "Për buxhetin e vitit 2011", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kompensimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël, të përdorur për rimbursimin e vlerës së pajisjeve fiskale e të taksimetrave, për njësitë e qeverisjes vendore, konkretisht, 5 (pesë) bashki dhe 10 (dhjetë) komuna, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Fondi, në vlerën 100 896 885 (njëqind milionë e tetëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e pesë) lekë, të përballohet nga Fondi i Kontigjencës, i miratuar në buxhetin e vitit 2011.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha